

Homoseksualizmi dhe mendimet kontradiktore

# Dr. Agani: Gjuha e urrejtjes është e panjohur për mua

EPOKA  
E RE

A. PLLANA

Prishtinë, 6 tetor - Neuropsikiatri dr. Ferid Agani, u është përgjigjur nëpërmjet një komunikate, organizatave joqeveritare "Iniciativa Rinore për të Drejtat e Njeriut" dhe "Qendra për Emancipimin Shoqëror", të cilat kanë botuar një komunikatë në gazetën "Koha ditore", më 2 tetor 2006.

Çështja ka të bëjë me deklaratën e tij mbi homoseksualizmin, dhënë gazetës "Iliria Post".

Në këtë komunikatë ai, ndër të tjera, ka thënë se "Këto dy organizata e kanë keqkuptuar këtë deklaratë në mënyrën më serioze, duke e cilësuar si tendencioz personalitetin tim dhe çështjen në fjalë. Shfrytëzoj këtë rast për ta qartësuar këtë çështje, të cilën e konsideroj, veçanërisht të rëndësishme në aspektin e të drejtave të njeriut në Kosovë. Fillimisht dëshirojë t'i ritheksojë dhe t'i sqarojë qëndrimet e mia lidhur me homoseksualizmin.

1. Si anëtar i komunitetit profesional dhe shkencor, të gjitha aktivitetet e mia kanë qenë dhe do të jenë të mbështetura mbi rregullat dhe parimet e tij themelore. Mbështetur në këtë fakt, edhe në deklaratën time, fillimisht kam theksuar se homoseksualizmi, aktualisht nuk konsiderohet si sëmundje ose çrregullim psikik nga



ana e organizatave më të rëndësishme ndërkombëtare në lëminë e psikiatrisë ose psikologjisë.

2. Njëkohësisht, gjatë punës sime shumëvjeçare klinike, në shumë raste kam trajtuar persona homoseksualë, të cilët lëngonin nga çrregullime psikiatrike, që në një mënyrë ishin të lidhura me identitetin e tyre seksual. Këto përvoja klinike, krahas vlerësimeve të qarta për këtë çështje në librat e shenjtë dhe kundërthënia e tyre me pozicionin e sipërpërmendur, zyrtarë të institucioneve relevante ndërkombëtare më kanë shtyrë të konkludojë se shkenca ende nuk i ka dhënë përgjigjet përfundimtare lidhur me këtë çështje.

Deklarata ime në mënyrë parësore reflekton perspektivën personale, të kushtëzuar me aspektin kulturor

të kësaj çështjeje, si dhe përvojën time klinike të lidhur me të. 3. Individët me orientim homoseksual janë subjekt i diskriminimit në shumë shoqëri; në disa raste, kjo fatkeqësisht ka ndodhur edhe në shoqërinë kosovare. Të qenit subjekt i çfarëdo lloji të diskriminimit, mund të shkaktojë çrregullime serioze të shëndetit mendor.

Shoqëria dhe institucionet e Kosovës duhet ta luftojnë, pa asnjë hezitim, diskriminimin e çfarëdo lloji dhe të promovojnë aktivitete në këtë drejtim, duke siguruar përkrahje të plotë për qytetarët, të cilët kanë nevojë për këtë.

Jam koshient, që këto fakte nuk kanë qenë në mënyrë të mjaftueshme të elaboruara në deklaratën time. Ofendimi dhe promovimi i urrejtjes, veçanërisht ndaj grupeve vulnerable shoqërore është në kundërshtim të plotë me parimet e angazhimit tim në sferën publike. Gjuha e urrejtjes është e panjohur për mua.

Besoj se të dhënat lidhur me punën time në lëminë e të drejtave të njeriut flasin për vete. Është e qartë se ekziston nevoja që t'i qasemi kësaj çështjeje me shkallë të shtuar të ndjeshmërisë, në kuadër të forumeve ose debateve të përgatitura mirë, profesionale dhe edukative. E shpreh gatishmërinë time të plotë për të kontribuar në këtë drejtim", përfundon dr. Ferid Agani.